

# CEREMONIA E VITIT TË 5-TË TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Dr.sc. Fejzullah Hasani - Kryetar i Gjykatës Supreme

*-Fjalim -*

“Bashkëpunimi ndër-institucional si kontribut në zhvillimin e demokracisë  
dhe konsolidimit të shtetit ligjor”



{15 tetor 2014}



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO**



Date: 15. 10.2014

I nderuari Kryetar i Gjykatës Kushtetuese z. Hasani

Të nderuar anëtarë të Gjykatës,

Të dashur miq,

Të nderuar pjesëmarrës,

Zonja dhe zotërinj,

Ndjehem i nderuar të jem sot mes anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët për vetëm pesë vite kanë kontribuar mjaftë shumë me punën dhe veprimtarinë e tyre drejt orientimit të drejtësisë kushtetuese në Kosovë.

Në forume të ndryshme, me audience qoftë të vendit apo ndërkombëtare rrallë e hiq na bie të dëgjojmë mbi traditën kushtetuese të Kosovës, nëse ekziston ajo, apo nëse e tëra që ekziston është ajo që kemi krijuar nga viti 2009 dhe sot po festojmë 5 vjetorin e punës së saj!

Sigurisht që mund të flitet shumë për traditën tonë në këtë aspekt, për drejtësinë kushtetuese si koncept në zhvillim, për zgjerimet dhe ngushtimet e sferave të juridiksionit, varësisht nga zhvillimet politiko-ushtarakë të periudhave të ndryshme kohore gjatë historisë, dhe pikërisht historia na tregon, pa dashur të thellohem shume

në këtë fushë, por do e nisë shkarazi nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, një lloj “kushtetute” e respektuar nga një pjesë e mirë e shqiptarëve për shekuj, ku vendimet e rëndësishme merreshin nga kuvendet e pleqve që kanë shërbyer si një lloj interpretuesish të këtij dokumenti, dhe deri në kohët më të reja, në ish jugosllavi, me ndryshimet kushtetuese që pasuan nga viti 1968 deri 1972, kur u formua Gjykata Kushtetuese e Kosovës, puna e së cilës pezullohet në vitin 1989 me suprimim e autonomisë së Kosovës, dhe tani me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pa dyshim se zhvillimet pas vitit 1999, sakrificës së madhe të popullit tonë dhe ndihmës së pakursyer të aleatëve tanë ndërkombëtare, i kanë dhënë një shtytje të madhe zhvillimit të shoqërisë kosovare dhe orientimit të saj demokratik, duke i hap rrugë shndërrimeve për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut pa dallim përkatësie etnike apo fetare,... parime dhe standarde që sot janë thellë të ngulitura në Kushtetutën e vendit. Por të gjitha këto do ishin të pavlerë nëse ne dështojmë të njohim dhe respektojmë edhe trashëgiminë tonë, duke njohur vlerat e së kaluarës: juridike, politike e kulturore, dhe virtytet thelbësore të saj, në mënyrë që të mund të ndikojmë në zhvillimin e mirëfilltë të gjeneratave të reja dhe shoqërisë sonë në frymën e respektimit të ndërsjellë, pavarësisht dallimeve.

Lidhjet e thella mes vlerave të së kaluarës, sakrificës, nevojës për drejtësi, standardeve kushtetuese moderne, interpretimi dhe zbatimi i tyre në praktikë, etj., i m ‘veshin institucionit të gjykatës kushtetuese një përgjegjësi për të cilën jemi plotësisht të vetëdijshëm se nuk është e lehtë. Një përgjegjësi që deri më sot, fal punës së saj të mirë është përkthyer në një mbështetje të vazhduar dhe të kujdesshme nga të gjithë, institucionet e vendit, popullata dhe partnerët tanë ndërkombëtar, një angazhim që – pa asnjë dyshim – mund të përkufizohet si një nga të arriturat më të madha të punës dhe profesionalizmit të këtij institucioni, ruajtja dhe kultivimi i së cilës duhet të vazhdoj, pa ra nën ndikimin e presioneve të ndryshme apo interesave ditore politike të akterëve të shumët që rrethojnë skenën kosovare.

Për këto pesë vite, kontrolli kushtetues i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese është treguar si forma më e mirë e gjetur për të siguruar kushtetutshmërinë funksionale të organeve shtetërore, me qëllimin e vetëm për të mos i lënë vend arbitrariteteve dhe anarkisë, me pasoja të drejtpërdrejta tek individët dhe tek niveli i demokracisë në vend. Dhe këtë ju e keni dëshmuar mjaftë suksesshëm.

Të gjithë e dimë se jo shumë gjatë pas themelimit, gjykata u gjet në qendër të vëmendjes duke adresuar raste shumë komplekse dhe politikisht të ngarkuara. Në këto rrethana, ajo dëshmoi të jetë e përgatitur për detyrat dhe nxori një sërë vendimesh të rëndësishme, të arsyetuara mirë, dhe të pranuar mirë. Megjithatë, dihet se në praktikë situatat shpesh janë më komplekse dhe këtu ndikon dukshëm kultura politike, juridike, stadi ekonomik dhe shoqëror, e të tjerë faktorë që dominojnë në vend. Këta faktorë shpjegojnë dhe diferencat mes vendeve me demokraci të konsoliduar nga vendet me demokraci në zhvillim, edhe pse në nivelin juridiko-formal mund të jenë palë e të njëjtave konventa dhe akteve ndërkombëtare. Në këtë kontekst, mund të kuptohen edhe sfidat, jo vetëm të Gjykatës Kushtetuese si një nga promotoret e realizimit të drejtësisë kushtetuese, por edhe nga gjykatat e rregullta dhe të gjithë ne që sot kemi të m'veshur petkun institucional, me përgjegjësin për të ushtruar, zbatuar dhe për të dhënë drejtësi.

Padyshim, drejtësia që ofron një shtet është themeli i funksionimit të shtetit; është themeli i funksionimit të shtetit të së drejtës, është garancia për funksionimin normal të çdo institucioni; është një shërbim thelbësor për shoqërinë, që synon përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besimit të tyre. Cilido prej institucioneve apo akterëve, pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë, në çdo çast të veprimtarisë së tij, ka në dorë të gjenerojë ndihmesën e vet në drejtim të rritjes së

pavarësisë, paanshmërisë, përgjegjshmërisë, edukimit ligjore dhe efijencës në institucionet e rendit dhe ligjit, dhe të sundimit të së drejtës.

Gjatë gjithë kësaj kohë, angazhimi i im si kryetar i Gjykatës Supreme, me qëllim rritjen cilësore të veprimtarisë së gjykatave, ka gjetur mbështetje të pakursyer nga Gjykata Kushtetuese, dhe falë kësaj bashkëpunimit tona institucionale janë gjithnjë më të shpeshta, si në këmbim përvojash, interpretim dispozitash kushtetuese dhe të praktikave ndërkombëtare, që pa dyshim duhet të përkrahen dhe të nxiten edhe nga nivele tjera.

Gjithashtu, angazhimi im në rritjen e pavarësisë, efijencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve gjyqësore nuk do të zbehet në asnjë çast; dhe nën këtë frymë nxitëse puna jonë e përbashkët përbën një domosdoshmëri të kohës, në vijim të konsolidimit të shtetit ligjor dhe demokracisë funksionale në vend. Ashtu siç është pranuar dhe pohuar gjerësisht, zhvillimet në gjyqësor duhet të jenë tërësore, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt parimeve evropiane e ndërkombëtare për një gjyqësor efikas, të pavarur, të paanshëm dhe mbi të gjitha, të besueshëm.

Bazuar mbi këtë koncept, dhe frymën “e një aktivizmi konstitucionalist” që vetëm brenda pese viteve të funksionimit të vet, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ka arritur të ndihmojë zhvillimin e ushtrimit të demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Padyshim, probleme dhe sfida ka kudo, ato i karakterizojnë edhe demokracitë më të hershme dhe më të konsoliduar se ne, dhe nuk mund të pretendojmë që vetëm për 15 vjet të kemi ngritur një sistem gjyqësor të përkryer, apo brenda 5 viteve një gjyqësi kushtetuese të konsoliduar, por mund të konstatojmë se gjyqësori ynë, për nga organizimi, liria dhe profesionalizmi që e karakterizojnë, padyshim që konkurren dhe me eksperiencë të tjera pozitive, dhe këtë duhet ta shfrytëzojmë, në të mirë të konsolidimit të vendit dhe rritjes së shërbimeve për qytetaret tanë, pa dallim, duke shfrytëzuar integritetin profesional e moral, që puna

jonë ti kontribuojë stabilitetit të demokracisë dhe zhvillimit të qartësisë juridike si një nga elementet themelore të sundimit të ligjit.

Urime dhe suksese të mëtejme në punën tuaj.

*Ju faleminderit!*